

Tirane më _____.____.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Evadimi dhe trajtimi I mbetjeve infekte spitalore , Marrveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara per nje periudhe 12 mujore.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 90520000-8

VLERA E FONDIT LIMIT/Marrevshjes Kuader: 1,809,000 (Një milionë e tetëqind e nëntë mijë) lekë pa TVSH., financuar nga buxheti i Shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **QKTGJ** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik“ neni 34 dhe VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 12 pika 4, dhe neni 76, pika 1c, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, përlllogaritja e vlerës limit të kontratës u bë mbi bazën e marrëveshjes kuadër (kontratës se fundit) të vitit 2022, nr. Prot. 176/8, datë 02/06/2022.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik te kete Leje Mjedisore tipi B me kod III.1.B se bashku me AKT Miratimin perkates, dhe Licencen Profesionale perkatese III.2.B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore),qe te perfshijne mbetjet e mprehta, infektive dhe te tjera (orientim respektivisht ne kodet 18 01 01, 18 01 02, te Katalogut shqiptar te mbetjeve), ku procedura e asgjesimit te jete Autoklavim dhe/ose incenerim.

Argumentim: Në bazë neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet : *mund t’u kërkojë ofertuesvetë paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ne perputhje me nenin 37 te LPP.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo me pak se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo me pak se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë sa 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën sa 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “Kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vertetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve.

Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi dhe/ose Inxhinier Agromjedisi dhe/ose Inxhinier Kimist.

Për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për stafin me siper:

Librezë pune (përkatëse)

CV përkatëse

Kontrata pune e vlefshme (përkatëse)

Diplome

Sqarim: kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga OE të Formularit Përmbledhës së Vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues para dhenies së kontratës.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” citohet që për të provuar përshtatshmerinë për të kryer veprimtarinë profesionale Ak ka të drejtë të kerkojë b) një listë të personelit kryesor, të

nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese certifikatat perkatese te vlefshme sipas objektit qe prokurohet, si me poshte:

- ISO 9001:2015 mbi“Sistemet e menaxhimit cilësisë”,

Argumentimi: Në bazë neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet : *mund t’u kërkojë ofertuesvetë paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë,*

1. Për transportin e mbetjeve, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht 1 (një) automjet të izoluar hermetikisht me kapacitet transportues jo me pak se 200 Kg, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjen dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore (në përputhje me pika 8.8/c dhe Shtojces nr.4 të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni: 9.3.3 ‘Automjetet/anjete e grumbullimit’).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b/c//c/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri *kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

2.3.4 Operatori duhet të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë ose të marrjes me qera të mjetit.

Për të vërtetuar këtë kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për automjetin në pronësi: *Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto te mjetit ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese sipas udhëzuesit kombëtar ”Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.*

Për automjetet që nuk janë në pronësi: *Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjeno sanitare, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.*

Sqarim: *kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga OE te Formularit Permbledhes se Vetdeklarimit, sipas shtojces perkatese te DST dhe dokumentacioni i kerkuar do te paraqitet nga ofertuesi fitues para dhenies se kontrates.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri *kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

2.3.5 Deklarate e OE që do të vendose në dispozicion të QKTGJ, kontenitore sipas standarteve të OBSH dhe VKM 798 date 20.09.2010, *Udhëzuesit kombëtar, "Administrimi i sigurt i mbetjeve spitalore", "Mbi mbetjet spitalore"*. Per kontenitore te kapaciteteve te meposhtme:

- a. Mbetje infektive prerese dhe shpuese – duke filluar nga minimumi 0.6 L deri ne maksimumi 6.5L
- b. Mbetje infektive (kontenitore plastik) – minimumi 40L deri ne maksimumi 60L.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

2.3.6 OE duhet të paraqesin vetedeklarim se do të vere në dispozicion të QKTGJ një frigorifer +2 °C - +6 ° (Pasi kjo temperature është e përshtatshme për ruajtjen e qeseve të gjakut), më kapacitet minimumi 100 litra (per te ruajtur mbetjet per nje periudhe disa ditore sipas nevojave te AK). Frigoriferi do të jetë në përdorim përgjat gjithë periudhës së Marrveshjes Kuader.

2.3.7 Dokument që verteton se ka në pronësi ose me qera impjant incenerimi dhe/ose autoklavimi të evidentuar në Leje Mjedisore, me kapacitet të mjaftueshem (minimumi 40kg/dite) për të perballuar sasinë e mbetjeve spitalore objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 a/c/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Per te provuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret duhet te paraqesin:

- a. Dokument që provon pronësinë apo disponimin me qera në një nga menyrat e parashikuara nga legjislati shqiptar (kontrata blerje ose qeraje, fature blerje ose zhdoganimi).

Sqarim: *kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga OE te Formularit Permbledhes se Vetdeklarimit, sipas shtojces perkatese te DST dhe dokumentacioni i kerkuar do te paraqitet nga ofertuesi fitues para dhenies se kontrates.*

- b. Deklaratën e Konformitetit CE ose FDA të impiantit/impianeteve të leshuar nga kompania prodhuese.
- c. OE duhet të paraqesin Akt-Miratimi Higjeno sanitar për ndërtesën ku është instaluar impianti.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike: Bashkëlidhur edhe në SPE.

Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve infekte spitalore

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Teknologjia e përdorur duhet të jetë e pajisur me deklarate konformiteti CE ose FDA nga prodhuesi i impiantit/impianeteve.

2. Teknologjia e përdorur duhet të bëjë të mundur që nepermjet procesit të sterilizimit në të njëjtin moment të kryhet reduktim volumor dhe sterilizim i mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet në temperaturën jo më të vogël se 130⁰C, ose teknologjia e përdorur të jetë me incenerim.

3. Kontenitorët që do të përdoren për transportin duhet të jenë CE ose FDA. Etiketimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me shtojcën 2 të Rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore, Sipas përcaktimeve të bëra në VKM 798, dt.29.09.2010 “*Per administrimin e mbetjeve spitalore*”, si dhe Udhëzuesit kombëtar “*Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore*”, të gjithë kontenierët që përdoren nga QKTGJ duhet të merren nga firma dhe të bëhet dezinfektimi i tyre prej saj. Qeset dhe kontenierët duhet të mbulohen nga sipërfaqsi dhe në rastin kur janë plastike shumë përdorimëshe, duhet të sigurohet larja dhe dizinfektimi i tyre në çdo ripërdorim.

Për arsye të hapësirave fizike dhe për një menaxhim sa më të mirë të shërbimit, kontenierët duhet të jenë me kapacitet si vijon:

- Mbetje infekte prerese dhe shpuese – *minimumi 0.6L deri në maksimumi 6.5L (L= Litra)*

- Mbetje infektive – *minimumi 40L deri në maksimumi 60L.*

4. Transporti duhet të kryhet në përputhje me shtojcën 4 të Rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore miratuar me VKM nr . 798 dt 29.09.2010.

5. Në çmimin e ofertuar duhet të përfshihen dhe vlera e kontenitoreve me një përdorim ku do të futen mbetjet infekte si dhe transporti i tyre.

6. Shërbimi duhet të kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar, Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”.

Lista e mbetjeve që do të evadohen dhe trajtohen:

Qese Gjaku të infektuar

Qese Gjaku të skaduar

Qese Plazme

Qese Trombociti të skaduar ose hemolizë

Tuba me gjak

Tuba seroteke me produkte gjaku të skaduar

Bishta (nga qeset) me gjak

Shiringa me gjak

Shishe qelqi hemokulturë

Age me gjak

Tuba të hapur me gjak

Grumbullime të agjentëve infektues që krijohen nga laboratorët, etj

Mbetjet e lengshme (infekte), të prodhuara nga pajisjet/aparaturat e testimi të gjakut.

Shërbimi do të kryhet sipas kërkeses së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku.

Mbetjet do të peshohen në praninë e perfaqesuesve të të dyja palëve.

Sipërmarrësi duhet të vërë në dispozicion të QKTGJ një frigorifer $+2^{\circ}\text{C}/+6^{\circ}\text{C}$ (Pasi kjo temperaturë është e përshtatshme për ruajtjen e qeseve të gjakut), me kapacitet 100 litra (për të ruajtur mbetjet për një periudhë disa ditore sipas nevojave të AK). Frigoriferi do të jetë në përdorim për gjatë gjithë periudhës së Marrvëshjes Kuadër.

Sipërmarrësi duhet të vërë në dispozicion të QKTGJ një peshore të kolauduar për peshimin e mbetjeve, në përdorim për gjatë gjithë periudhës së Marrvëshjes Kuadër (me afat 12 muaj).

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar dhe në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.